



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 14

Prishtinë, më 13.05.2015, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Valdete Bajrami, Etem Arifi dhe Kujtim Paçaku.

Mungoi: Slavko Simiq.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit, UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Valmira Rushiti-YIHR-KS, Tetuta Hoxha-YIHR-KS, Visar Bivolaku-EU/EUSR, Ukë Gashi-ZRPK, Lejla Selimi-OSBE, Adelin Sahiti-Kosova Press dhe Arta Xhylani- Praktikante e Kuvendit të Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes, nr. 13;
3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për 2014. (I ftuar për këtë pikë të rendit të ditës është Avokati i Popullit, z. Sami Kurteshi);
4. Formimi i grupeve punuese për amendamentimin e Projektligjeve;

5. Marrja e Vendimit për mbajtjen e dëgjimeve publike;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja- Tha se meqenëse Raporti Vjetor për Avokatin e Popullit, për arsye të përkthimit nuk ka arritur të shpërndahet me kohë dhe Avokati i Popullit ishte i angazhuar në intervistimin e kandidateve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, pika e tretë e rendit të ditës nuk do të shqyrtohet në këtë mbledhje.

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes, nr. 13

Mytaher Haskuka- Tha se në fjalinë e tij, që të sigurohen kompetenca për funksionalizimin profesional dhe teknik dhe jo për funksionalizimin profesional të teknikave. Po ashtu ai mendon që kërkesat e peticionit të paraqiten ashtu në Kuvend, e jo rekomandimet siç ceken këtu.

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes se mbajtur më .29.04.2015, u miratua me vërejtjen e anëtarit të Komisionit, z. Mytaher Haskuka.

4. Formimi i grupeve punuese për amendamentimin e Projektligjeve

Kryetarja- Tha se për shqyrtimin e tri projekt ligjve të cilat kanë kaluar shqyrtimin e parë në Kuvend do të formojmë grupet punuese.

Kërkon nga administrata e Komisionit që të sigurojë transkriptin e seancës kur janë shqyrtuar këto projektligje në Kuvend, sepse ka pasur propozime të mira nga deputetët për këto tri projektligje, e që do t'iu hynë në punë.

Ajo propozon që grupet punuese të kenë këtë përbërje, nëse pajtohet Komisioni:

Në grup punues për Projektligjin e Avokatit të Popullit të jenë, Mytaher Haskuka kryesues, Mexhide Mjaku-Topalli dhe Etem Arifi, antarë.

Në grup punues për Projektligjin për Barazi Gjinore të jenë: Lirije Kajtazi- kryesuese, Valdete Bajramin dhe Kujtim Pacaku, anëtarë.

Në grup punues për Projektligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi të jenë: Teuta Haxhiu kryesuese, Salihe Musafa dhe Slavko Simiq, anëtarë.

Kryetarja konstatoi se Komisioni unanimisht vendosi të nxjerrë këto:

Përfundime

I. Formohet Grupi i raportuesve për shqyrtimin e Projekt ligjit për Avokatin e Popullit në këtë përbërje:

1. Mytaher Haskuka, kryesues,
2. Hetem Arifi, anëtar,
3. Mexhide Mjaku-Topalli, anëtare.

I. Formohet Grupi i raportuesve për shqyrtimin e Projekt ligjit për Barazi Gjinore me këtë përbërje:

1. Lirije Kajtazi, kryesuese,
2. Kujtim Paçaku, anëtar,
3. Valdete Bajrami, anëtare.

I. Formohet Grupi i raportuesve për shqyrtimin e Projekt ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me këtë përbërje:

1. Teuta Haxhiu, kryesuese,
2. Slavko Simiq, anëtar,
3. Salihe Mustafa, anëtare.

5. Marrja e Vendimit për mbajtjen e dëgjimeve publike

Kryetarja- Tha se këto projektligje kanë ardhur në pako dhe është mirë të mbahet dëgjimi publik i përbashkët, për të tri projektligjet, dhe për mbajtjen e dëgjimit publik propozon datën 25 maj 2015, nëse me këtë pajtohen edhe anëtarët e tjerë të Komisionit.

Teuta Haxhiu- Tha se pajtohet që të mbahet dëgjimi publik i përbashkët për tri projektligjet, por kërkon që data të ndryshojë pasi nuk mundet të jetë prezent dhe propozon ditën e mërkurë, data 27 maj.

Mytaher Haskuka- Tha se ai është që dëgjimi publik të caktohet më 27 maj.

Salihe Mustafa- Tha se i vjen keq që Teuta nuk mund të marrë pjesë në këtë datë, ata që dëshirojnë të jenë prezentë më së miri ndoshta do të ishte dita e hënë, pasi që edhe të mërkurën mundet të na dalë ndonjë surprizë pune, sepse secili po i ka detyrat e veta dhe është kompetencë e juaja të vendosni.

Teuta Haxhiu propozoi që të hidhen në votim dy propozime, për datën 25 dhe 27 dhe të mos bëhet problem kjo çështje.

Kryetarja i hodhi në votim të dy propozimet për mbajtjen e dëgjimit publik, datat 25 dhe 27 maj dhe konstatoi se Komisioni me 5 vota për dhe dy kundër është që dëgjimi publik për shqyrtimi e këtyre tri projektligjeve të jetë të hënën, më 25 maj 2015, në orën 10:00 në Hotel Sirius.

6. Të ndryshme.

Teuta Haxhiu -Tha se nuk mund të jetë prezent në dëgjim publik, dhe kërkon të jenë me të saktë në orar dhe të mos bëhet ndërrimi i orarit të mbledhjeve për afat kaq të shkurtër, pra brenda ditës. Pasi që po u shkakton probleme në zhvendosjen e agjendave.

Kryetarja- Sqaroi që ndryshimi i orarit të mbledhjes sot, ka ndryshuar për arsye që edhe takimi me përfaqësuesit e OSBE-së është shtyrë pa dashjen e tyre e në mënyrë që të mos keni hapësirë të madhe të kohës të pritjes, sepse të gjithë kanë takime e obligime, ka menduar që është më mirë për të gjithë.

Kryetarja- Tha që tani e kemi të përkthyer Raportin e Avokatit të Popullit, dhe mendon që gjatë javës të mbajnë mbledhje edhe pse ka seancë, a do të ishte e mundur takimi në orën 9:00 të ditës së nesërme ose pasnesër?

Mytahir Haskuka- propozon për ditën e nesërme, të enjten, datën 14.05.2015, në orën 9:00, nëse pajtohen edhe anëtarët e tjerë të Komisionit.

Kryetarja -pyeti se a do të ishte e mundur të zgjedhet edhe paneli rekrutues për intervistimin e Avokatit të Popullit, pasi që nuk ka propozime për ndryshime. Ajo kërkon që të jenë të njëjtët anëtarë.

Kryetarja konstatoi se komisioni unanimisht vendosi të nxjerrë këtë

Vendim

1. Formohet Paneli rekrutues dhe emërohet kryesuesi i Panelit për rekrutimin e kandidatëve për Avokat të Popullit, me këtë përbërje:
 - Lirije Kajtazi (G- LDK) kryesuese e Panelit,
 - Salihe Mustafa (G-PDK) anëtare,
 - Slavko Simiq (G-L S) anëtar,
 - Mytahir Haskuka (G- LVV) anëtar,
 - Teuta Haxhiu (AAK) anëtare,
 - Valdete Bajrami (GP- Nisma) anëtare,
 - Kujtim Paçaku (GP-6+) anëtar.

Teuta Haxhiu- Pyeti për pagën e Avokatit të Popullit, që është e paraparë që një vit pas mandatit t'i vazhdojë paga, dihet se këtij i ka kaluar mandati e tani kur do të zgjidhet avokati i ri, a do t'i vazhdohet edhe për një vit tjetër (këtij avokati) paga.

Kryetarja- Tha se duhet t'i vazhdohet pasi që pa shkakun e tij është zgjatur kjo kohë dhe do të duhej të vazhdohet paga edhe për një vit.

Salihet Mustafa- E njoftoi Komisionin për monitorimin e ligjit për të verbër që grupi punues ka përfunduar punën e vizitave në terren. Dje kanë qenë në Pejë, ndërsa sot në Ministrinë e Infrastrukturës edhe pse kjo nuk kishte marrë pjesë mirëpo e ka zëvendësuar deputetja Mexhide, me deputetët Mytaher dhe Etem. Ajo tha se në këtë mënyrë do të fillohet raporti i punës që të përfundojmë e të dërgohet në Kuvend këtë sesion raporti me rekomandime. Ajo tregoi se grupi punues ka vizituar shoqatat e të verbërve në Prishtinë, Gjilan dhe Pejë, Ministrinë e Shëndetësisë, Arsimit, Punës dhe Mirëqenies sociale, Ministrinë e Infrastrukturës, Qendrën e shkollës Speciale në Pejë dhe Komunën e Pejës.

Mytaher Haskuka- Tha se sipas ligjit personat me aftësi të kufizuara mund të marrin vetura pa taksë dhe doganë, ndërsa dogana po iu kërkon që të kenë patentë shofer që të mund të marrin veturën, e që këtë gjë nuk mund të kenë personat e verbër, këtë çështje e ka shtjelluar edhe në seancë, andaj pse mos të mos vizitohet edhe selia e doganës.

Mexhide Mjaku-Topalli- Tregon që sot në vizitën në Ministrinë e Infrastrukturës, ministri kishte thënë që duhet t'iu drejtoheni Ministrisë së Financave sa i përket nenit 13 për udhëtime dhe lirime nga pagesa.

Komisioni Vendosi që të bëhet një vizitë në Ministrinë e Financave të premtën me dt. 15.05.2015, në orën 9:00

Kujtim Paçaku dëshiron të tregojë për kërkesën që të vizitohen zyrat e komuniteteve në njësitë komunale, pasi që për një javë janë të vonuar, për shkak të agjendës së ngjeshur që ka qenë javën e kaluar, por do të caktohen datat për vizita në komuna në akordim me administratën.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Lirije Kajtazi

